



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/196

Datë: 17.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 shtator 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Rregullorja për përcaktimin e rregullave dhe procedurën e punës së Këshillit Nacional për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.
2. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/196

Datë: 17.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 shtator 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Themelohet grupi punues për të analizuar politikën fiskale që ka të bëjë me TVSH-në në produktet bazë të konsumit, në këtë përbërje:
  - 1.1. Një përfaqësues nga Ministria e Financave, kryesues;
  - 1.2. Dy përfaqësues nga Ministria e Financave;
  - 1.3. Një përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit;
  - 1.4. Një përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
  - 1.5. Një përfaqësues nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
  - 1.6. Një përfaqësues nga Dogana e Kosovës;
  - 1.7. Një përfaqësues nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe
  - 1.8. Një përfaqësues i shoqërisë civile në cilësinë e vëzhguesit.
2. Grupi punues mund të ftoj edhe përfaqësues dhe anëtarë të tjerë nese e sheh të nevojshme për ecurinë e punës së grupit.
3. Grupi punues ka për detyrë që të dal me një raport sa i përket normës së TVSH-së në produktet bazë të konsumit.
4. Grupi punues duhet të dal me një analizë të detajuar sa i përket çmimit të produkteve bazë të konsumit dhe shërbimeve publike në Kosovë dhe në vendet e rajonit; të analizoj çmimin në raport me të dhënat ekonomike të vendit; të analizoj normën e TVSH-së me vendet e rajonit dhe me gjerë; përparësitë dhe

dobësitë e çfardo ndryshimi eventual të normave të TVSH-së; ndikimin e uljes së mundshme të normave në situatën makroekonomike të Kosovës dhe nivelin e të hyrave, dhe me këtë rast t'i propozoj Qeverisë për veprimet e mëtejme në drejtim të ndryshimit të mundshëm të këtyre normave tatimore.

5. Puna e Grupit punues do të shërbej si Koncept-dokument për të vlerësuar nevojën e ndryshimit ose jo të politikave tatimore në Republikën e Kosovës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/196

Datë: 17.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 shtator 2014, mori:

**V E N D I M**

**Për themelimin e Grupit Punues për hartim të Programit Ekonomik Fiskal 2015**

1. Themelohet Grupi Punues për hartim të Programit Ekonomik Fiskal (më tutje i referuar PEF) i udhëhequr nga Zv. Ministri i Financave në këtë përbërje:
  - 1.1. Një përfaqësues nga Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Publike, Ministria e Financave;
  - 1.2. Një përfaqësues nga Zyra për Planifikim Strategjik/Zyra e Kryeministrit;
  - 1.3. Një përfaqësues nga Departamenti i Buxhetit, Ministria e Financave;
  - 1.4. Një përfaqësues nga Departamenti i Buxhetit Komunal, Ministria e Financave;
  - 1.5. Një përfaqësues nga Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, Ministria e Financave;
  - 1.6. Një përfaqësues nga Departamenti për Integrim Evropian, Koordinim të Politikave dhe Zhvillim Ekonomik, Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
  - 1.7. Një përfaqësues nga Departamenti i Tregtisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
  - 1.8. Një përfaqësues nga Departamenti i kriterëve ekonomike dhe tregut të brendshëm, Ministria e Integrimi Evropiane;
  - 1.9. Një përfaqësues nga Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar, Banka Qendrore e Kosovës;
  - 1.10. Një përfaqësues nga Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Agjencia e Statistikave të Kosovës;
  - 1.11. Një përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës;
  - 1.12. Një përfaqësues nga Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
  - 1.13. Një përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;

- 1.14. Një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë/Agjencia e Financimit të Shëndetësisë;
  - 1.15. Një përfaqësues nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Reformës së Administratës Publike.
2. Grupi Punues nga pika 1. e këtij vendimi ka këto detyra dhe përgjegjësi: të ndihmoj procesin e hartimit të PEF-it; të koordinoj materialet e dorëzuara nga institucionet përkatëse; të siguroj konsistencë dhe përputhshmëri në mes të politikave të propozuara në PEF me kornizën e përgjithshme fiskale dhe të monitoroj implementimin e PEF-it.
  3. Detyrat specifike të grupit punues janë:
    - 3.1. Mbikëqyrja e tërë procesit të përgatitjes së PEF;
    - 3.2. Ndarja e përgjegjësiave/detyrave në mes institucioneve, përkatësisht në përgatitjen e inputeve të tyre për draftet e PEF;
    - 3.3. Shqyrton draftet e PEF dhe sugjeron përmirësime;
    - 3.4. Diskuton dhe propozon zgjidhje për dallimet në mes të zotimeve të politikave, prioritetëve strategjike, parashikimeve makroekonomike dhe kornizës buxhetore;
    - 3.5. Merr në konsideratë zhvillimin e politikave dhe informatat kthyesë për PEF nga institucionet e Bashkimit Evropian dhe sugjeron mënyrën e adresimit të tyre;
    - 3.6. Monitoron implementimin e politikave dhe objektivave të zotuarra në PEF;
    - 3.7. Merr në konsideratë propozimet për të përmirësuar procesin e përgatitjes së PEF;
    - 3.8. Kryen punë tjera të nevojshme për përgatitje të suksesshme dhe implementim të PEF;
  4. Grupi Punues aq sa është e mundur, do të synojë të integroj përgatitjen dhe monitorimin e PEF në kuadër të formulimit të monitorimit të politikave tjera brenda Qeverisë.
  5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/196  
Datë: 17.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 shtator 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për rekomandimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes për Kredi Eksportuese ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG lidhur me financimin e Projektit Hibrid të Integruar për Qendrën e Kardiokirurgjisë të Klinikës Universitare të Kosovës.
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij vendimi, komform afatit të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/196

Datë: 17.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 dhe 5 të Ligjit nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 shtator 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në cilësinë e ushtruesit të ligjshëm të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në Ndërmarrjen Publike "Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A." ("PTK"), vendos se Ministri i Financave ("Ministri"), autorizohet dhe urdhërohet të veprojë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si aksionar i vetëm në PTK, dhe të ndërmarrë të gjitha masat e ligjshme, të nevojshme dhe të përshtatshme të aksionarit për realizimin e veprimit në vijim në periudhën më të shkurtër kohore të mundshme ligjërisht:
  - 1.1. Të kërkojë nga PTK dhe Bordi i saj i Drejtorëve që menjëherë të deklarojnë dhe paguajnë një dividendë ("Dividenda") për aksionarin në shumën prej 10.000.000 (dhjetë milion) euro.
2. Obligohet Ministri i Financave që në bashkpunim me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik dhe Bordin e Drejtorëve të Post Telekomunikacionit të Kosovës Sh.A. të caktojë dinamikën e ekzekutimit të obligimit të pikës 1.1. të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/196

Datë: 17.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 shtator 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Këshillit organizativ për shënimin e ditës së boshnjakëve për ndarjen e mjeteve financiare në shumë 24,800.00 euro për festimin e ditës së komunitetit Boshnjak në Kosovë.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Zyra për Komunitete në Zyrën e Kryeministrit, Kodi i Programit 15600 dhe barten në xhirollogarinë 1126001615000103 në Pro Credit Bank.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/196

Datë: 17.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-221, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 shtator 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti Gjashtëmujor i Buxhetit për vitin 2014.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/196

Datë: 17.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 shtator 2014, mori:

**V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R**

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik me krijimin e të drejtës së servitutit i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Linjës Energjetike 400 kV Kosovë-Shqipëri, segmenti I-parë 16 km, Zonat Kadastrale Obiliq, Milloshevë dhe Plemetin të Komunës Obiliq, Zonat Kadastrale Prilluzhë, Bivolak, Strofc dhe Zhilivodë të Komunës së Vushtrrisë dhe Zonat Kadastrale Gradicë dhe Gllanasellë, Komuna Drenas, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, ne pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka

një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi.

6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.
7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Kompania Publike "Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut" Sh.A (KOSTT) do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/196

Datë: 17.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, si dhe nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2011 dhe nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 shtator 2014, mori këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës mbështet sanksionet e Institucioneve të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj entiteteve juridike dhe autoriteteve të Federatës Ruse.
2. Sanksionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, janë përcaktuar në Shtojcën nr. 1. bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Sanksionet do të jenë në fuqi deri në një vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
4. Ngarkohen Ministria e Financave, Banka Qendrore, Njësia e Inteligjencës Financiare dhe institucionet e tjera përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

## SHTOJCA Nr. 1

Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në vendimin e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe institucioneve të Bashkimit Evropian më datë 16 Korrik 2014, 31 Korrik dhe 12 Shtator 2014, vendos sanksione ndaj pasurisë së këtyre entiteteve juridike, autoriteteve dhe individëve, që kanë shkelur sovranitetin e Ukrainës, si vijon :

1. Institucione financiare :

- 1.1. Gazprombank OAO
- 1.2. VEB.
- 1.3. Bank of Moscow,
- 1.4. Russian Agricultural Bank,
- 1.5. Sberbank,
- 1.6. VTB Bank.

2. Bllokimin e aseteve të :

- 2.1. OAO 'Dolgoprudny Research Production Enterprise.
- 2.2. Mytishchinski Mashinostroitelny Zavod OAO.
- 2.3. Kalinin Machine Plant JSC.
- 2.4. Almaz-Antey GSKB.
- 2.5. JSC NIIP.

3. Shoqëri që operojnë në sektorin e energjisë :

- 3.1. OAO Novatek.
- 3.2. Gazprom.
- 3.3. Gazprom Neft.
- 3.4. Lukoil.
- 3.5. Surgutneftegas.
- 3.6. Rosneft.

4. Shoqëri me veprimtari tregtare, që ofrojnë shërbime në kërkime nënujore ne fushën e energjisë, si :

- 4.1. Gazprom.
- 4.2. Gazprom Neft.
- 4.3. Lukoil.
- 4.4. Surgutneftegas.
- 4.5. Rosneft.

5. Shoqëri me veprimtari në fushën transaksionet financiare, si :

- 5.1. Gazprom Neft.
- 5.2. Transneft.

6. Shoqëri që veprojnë në sektorin e prodhimit të armëve :

- 6.1. Almaz-Antey.
- 6.2. Federal State Unitary Enterprise State Research and Production Enterprise Bazalt.
- 6.3. JSC Concern Sozvezdie.
- 6.4. JSC MIC NPO Mashinostroyenia.
- 6.5. Kalashnikov Concern.
- 6.6. KBP Instrument Design Bureau.
- 6.7. Radio-Electronic Technologies.
- 6.8. Uralvagonzavod.
- 6.9. Rostec.
- 6.10. OAO 'Dolgoprudny Research Production Enterprise.
- 6.11. Mytishchinski Mashinostroitelny Zavod OAO.
- 6.12. Kalinin Machine Plant JSC.
- 6.13. Almaz-Antey GSKB.
- 6.14. JSC NIIP.

7. Autoritete të vetëshpallura :

- 7.1. Institucione :
  - 7.1.1. Luhansk People's Republic.
  - 7.1.2. Donetsk People's Republic.
- 7.2. Individ :
  - 7.2.1. Aleksandr Borodai.

8. Ndërrmarje :

- 8.1. Feodosiya Enterprise.

9. Individë :

- 9.1. Sergey Besesda.
- 9.2. Oleg Savelyev.
- 9.3. Sergei Neverov.
- 9.4. Igor Shchegolev.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/196  
Datë: 17.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 shtator 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Komisionit Qeveritar për njohjen e statusit të ish të dënuarve dhe ish të përndjekurve politik për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 20,000.00 (njëzet mijë) euro për periudhën janar-dhjetor 2014.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara dhe barten në Ministrinë e Drejtësisë OB MD 215 programi 11315.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/196  
Datë: 17.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 shtator 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për mbështetje financiare në vlerë prej 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) euro për vitin 2014 për realizimin e projektit "ATOMI" të Qendrës për Studime, Shërbime Sociale dhe Psikologjike ENCOMPASS, për ofrimin e shërbimeve nxënësve të shkollimit parauniversitar në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, të cilët janë përzgjedhur me inteligjencë të jashtëzakonshme.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe barten në Qendrën ENCOMPASS në xhironlogarinë nr. 150 109 000 177 2942 në Raiffeissen Bank.
3. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë